



Diversiteti dhe gjithëpërfshirja sociale analizë e — e teksteve shkollore në Kosovë



PËRMBAJTJA

QËLLIMET E ANALIZËS	1
HYRJA	1
METODOLOGJIA	2
RËNDËSIA E DIVERSITETIT DHE GJTIHËPËRFSHIRJES NË TEKSTET SHKOLLORE	3
TË GJETURAT KRYESORE	4
KONKLuzionET	6
REKOMANDIMET	7

Qëllimet e analizës

- Qëllimi i parë i kësaj analize ishte të eksplorohej dhe të evidentohet se deri në çfarë mase antigjipsizmi, përmes gjuhës diskriminuese dhe të përjashtimit ndaj Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptasve është i pranishëm në tekstet shkollore publike të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët në Kosovë.
- Qëllimi i dytë i analizës është të shërbejë si bazë e të gjeturave për ndërmarrjen e veprimeve nga institucionet përkatëse për eliminimin e përmbajtjeve që promovojnë gjuhën diskriminuese dhe përjashtimin social, dhe plotësimin e tyre me materiale të cilat pasqyrojnë drejtë shumëllojshmërinë kulturore dhe etnike në Kosovë.
- Rëndësia e analizës qëndron në faktin se sistemi edukativ duhet të jetë në funksion të promovimit të diversitetit kulturor dhe gjuhësor, të luftojë paragjykimet e ndryshme etnike dhe kësajsoj të kontribuojë në ndërtimin e një shoqërie multietnike dhe gjithëpërfshirëse.

Hyrja

Cilësia e arsimit në Kosovë mbetet ende shqetësim sipas raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2020¹. Sipas këtij raporti nuk është bërë asnjë përparim i konsiderueshëm në fushën e arsimit. Duke qenë se Kosova karakterizohet me një trend në rritje drejt gjuhësisë në një nga gjuhët zyrtare, mungesa e platformave në të cilat anëtarët nga komunitete të ndryshme mund të bashkëveprojnë, shihet si një çështje shqetësuese.

Lidhur me cilësinë e arsimit dhe teksteve shkollore, edhe pse ka pasur ankesa dhe vërejtje në vazhdimësi për gjuhën e papërshtatshme dhe të papranueshme, përfshirë këtu dhe seksiste dhe denigruese, nga pjesëtarët e shoqërisë civile, nga vetë institucionet shkollore dhe prindërit, tekstet shkollore kanë pësuar

një revidim dhe ndryshim më së paku tre herë në tërësi që nga viti 2008, dhe kjo më tepër për arsye të ndryshimit në përmbajtjen e Kurrikulës Bazë të përpiluar dhe publikuar nga MASHT. Hyrja në fuqi e kurrikulës së re shkollore në vitin 2017 dhe vazhdimësia e përdorimit të teksteve shkollore me gjuhë të papërshtatshme po shihen si problematike nga njohësit e fushës. Revidimi i fundit i teksteve për shkollat fillore dhe të mesme është bërë në fillim të vitit 2019, e të cilat kanë hyrë në përdorim në vitin shkollor 2019/2020.

Edhe pas këtij revidimi, ankesa për gabimet, nivelin jo cilësor dhe pa mjete të konkretizimit, vazhduan të jenë valide². Në të njëjtën kohë, konsiderohet se fëmijët dhe të rinjtë nuk janë të ekspozuar, ose janë të ekspozuar në mënyrë minimale dhe/ose të

¹ COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT, Kosovo* 2020 Report, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf

² Deklarata nga perfaqësues nga Nisma për të Drejtat e Njeriut (YIHR) lidhur me nismën e revidimit të teksteve shkollore.

kufizuar, varësisht nga regjioni dhe komuna ku jetojnë, ndaj kulturës dhe gjuhës së njëritjetrit ose atyre të komuniteteve të tjera vendore. Një trend i tillë në planin afatgjatë mund të evitohet dhe zvogëlohet vetëm përmes sistemit arsimor.

Në komunitetet jo-shumicë, arsimit në nivelet para-universitare vazhdon të përballet me sfida kryesisht për shkak të mungesës së librave shkollorë në gjuhët e komuniteteve përkatëse³. Ndërsa, në tekstet shkollorë ekzistuese është evidentuar një mospërfshirje/përjashtim dhe hezitim i pranimit të diverzitetit kulturor dhe gjuhësor, në veçanti ndaj komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas. Antigjipsizmi si formë specifike e racizmit ndaj këtyre komuniteteve është historikisht i rrënjësor në Kosovë dhe një fenomen i cili duhet të evidentohet dhe të luftohet në mënyrë që arritja e drejtësisë sociale të jetë e realizueshme. Fenomeni i antigjipsizmit manifestohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Mospërfshirja, mosnjohja e historisë dhe kulturës së komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas në tekstet shkollorë, apo përshkrimi i narrativave të cilat vazhdojnë t'i forcojnë stereotipet dhe paragjykimet ekzistuese ndaj tyre – njihet si diskriminim strukturor dhe është një prej mënyrave më të shpeshta të manifestimit të antigjipsizmit. Tekstet shkollorë në Kosovë janë të njëanshme dhe paraqesin vetëm pikëpamjet e shumicës si norma dhe vlera të përgjithshme, duke injoruar kështu vlerat kulturore dhe historike të Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptasve. Këtë e mbështetë kjo analizë e teksteve shkollorë për arsimin fillor dhe të mesëm të ultë të realizuar nga ekipi hulumtues i organizatave të shoqërisë civile, Terre des hommes Kosova, dhe Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptasve.

Metodologjia

Gjatë vitit 2020 organizatat joqeveritare Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve dhe Terre des Hommes në Kosovë përfunduan me sukses trajnimin për trajnerë në fushën e antigjipsizmit. Gjithsej 12 punonjës të këtyre organizatave janë trajnuar nga Rrjeti Evropian i Organizatave Rome (ERGO) ekskluzivisht në lidhje me antigjipsizmin formën dhe mënyrën e manifestimit të tij. Në mënyrë që njohuritë e fituara gjatë trajnimit të transferohen në veprime konkrete analitike, ekipi ka vendosur të analizojë tekstet shkollorë të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët në Kosovë me theks të veçantë në identifikimin e përmbajtjeve të cilat manifestojnë gjuhën e urrejtjes dhe përjashtimin social dhe kulturor në raport me komunitetet e marginalizuara etnike, si romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit.

Ekipi hulumtues ka analizuar shumicën e teksteve shkollorë të arsimit fillor dhe të mesëm të ultë në gjuhën shqipe në shkollat publike në Kosovë, me theks të veçantë librat e historisë, edukatës qytetare, leximit dhe gjeografisë. Metoda e cila është përdorur gjatë analizës së teksteve shkollorë ishte leximi analitik dhe kritik i tyre nga anëtarët e ekipit hulumtues, ku secili ishte përgjegjës për tekstet shkollorë sipas klasave të ndara paraprakisht. Të dhënat e mbledhura për gjuhën diskriminuese e përjashtuese në tekstet shkollorë janë sistemuar nënjë bazë të të dhënave, duke bërë një kodim të të dhënave ashtu që të mund të analizohen: libri, autori, shtëpia botuese, drejtimi, klasa, faqja, paragrafi dhe citati. Mëpastaj, të gjitha të gjeturat i janë dorëzuar kordinatorit të hulumtimit, duke bërë rishikimin dhe validimin e të gjeturave.

³ Raporti i OSBE-së, "Qasja e komuniteteve në arsimin parauniversitar në Kosovë" (2018). Linku: https://www.osce.org/files/Community%20Education%20report_Albanian_layout.pdf

Rëndësia e diversitetit dhe gjithëpërfshirjes në tekstet shkollore

Mënyra se si fëmijët dhe të rinjtë edukohen afekton jo vetëm përceptimin e tyre për veten por edhe pikëpamjet e tyre për kombin dhe ndërtimin e imazhit për të tjerët. Nëse imazhi ndaj "tjetrit" është i mangët dhe jo kuptimplotë, dhe sistemi nuk e inkurajon mendimin kritik, këto përceptime shpesh mund të shkaktojnë rritjen e paragjyqimeve dhe stereotipeve ndaj grupeve të caktuara etnike. Studiuesit e fushës se edukimit kanë ardhë në përfundim se sistemi i edukimit i afekton strukturat e ndryshme sociale dhe mund të kontribuojë pozitivisht ose negativisht në ndërtimin e kohezionit social të një vendi.

Po ashtu, shumë Konventa Ndërkombëtare potencojnë se edukimi duhet të promovojë tolerancën dhe diversitetin. Këto parime janë të mishëruara në Deklaratën Univerzale për të Drejtat e Njeriut dhe në Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Sipas nenit 29, të kësaj të fundit, thuhet se, "edukimi duhet të bazohet mbi premisen e jodiskriminimit dhe duhet të zhvillohet mbi parimin e respektit për prindërit e fëmijës, për identitetin e tij, gjuhën dhe vlerat kulturore, për vlerat kombëtare të vendit ku fëmija jeton, të vendit të origjinës dhe të qytetërimeve të ndryshme nga i veti. Për më tepër, dispozita vijuese thotë se shtetet obligohen "ta përgatisin fëmijën për një jetë të përgjegjshme në një shoqëri të lirë, në frymën e mirëkuptimit, paqes, tolerancës, barazisë midis seksëve dhe miqësisë midis të gjithë popujve, grupeve etnike, grupeve kombëtare e fetare dhe personave me origjinë autoktone".

Për këtë arsye, përkrahja për sistemet edukative gjithëpërfshirëse si pjesë e rëndësishme në reduktimin e varfërisë konsiderohet si një ndër agjendat kryesore të Bankës Botërore dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.⁴

Studimet po ashtu argumentojnë se hartimi i teksteve shkollore gjithëpërfshirëse, kontribuon pozitivisht në përpjekjen e grupeve të marginalizuara etnike për fuqizim dhe barazi sociale.⁵ Shkollat mund të ndihmojnë që nxënësit e grupeve etnike të marginalizuara të aftësohen dhe fuqizohen. Këta faktorë janë të lidhur pozitivisht edhe me arritjet e tyre akademike.⁶

Në literaturën e fushës së edukimit multikulturor, studiuesi James Bank, e identifikon 'qasjen aditive' si një prej formave më të rëndësishme në inkuadrimitin e përmbajtjeve multikulturore në kornizat e planprogrameve dhe teksteve mësimore. Sipas kësaj qasje, përmbajtja, konceptet, temat dhe perspektivat në tekstet shkollore mund të plotësohen dhe shtohen pa e ndryshuar thelbin dhe qëllimet e teksteve mësimore. Në këtë kuptim, tekstet shkollore mund të rishikohen përmes plotësimit të tematikave të caktuara duke dhënë detaje dhe informacione më të plota dhe të sakta rreth grupeve të ndryshme etnike në një vend.⁷ Me anë të kësaj, sistemi i edukimit përmes rishikimit dhe plotësimit të teksteve shkollore me elemente multi-kulturore mund të shërbejë si katalizator në promovimin e multi-etnicitetit dhe forcimin e kohezionit social dhe luftimin e fenomenit të antigjipsizmit.

⁴ Roberts-Schweitzer, Eluned, Vincent Greaney and Kreszentia Due. Promoting Social Cohesion through Education: Case Studies and Tools for Using Textbooks and Curricula. Washington DC: International Bank for Reconstruction and Development / The World Bank, 2006 (p.2).

⁵ Bank, James, Cherry A. McGee Banks. Multicultural education: Issues and Perspectives. Vancouver: Garfinkel Publications, 2016 (p.186)

⁶ Coleman, James S. Equality of Educational Opportunity: U.S Department of Health, Education & Welfare Office of Education, 1966.

⁷ Bank, James, Cherry A. McGee Banks. Multicultural education: Issues and Perspectives. Vancouver: Garfinkel Publications, 2016 (p.187)

Përceptimet dhe qëndrimet të cilat janë të forta dhe nuk sfidohen gjatë viteve të shkollës janë shumë të vështira, për të mos thënë të pamundura të ndryshohen në moshën madhore. Kësisoj, kur nxënësit formojnë qëndrime negative të cilat përforcohen në librat shkollor ose nuk sfidohen në shkollë përgjatë mësimeve, atëherë këto qëndrime do të mbesin deri në moshën madhore dhe kështu do të ndikojnë në mënyrën se si ata ndërveprojnë në shoqëri.⁸

Në linjë me këtë, një nga qëllimet e arsimit parauniversitar në Kosovë është përgatitja e nxënësve për jetesë të përgjegjshme në frymën e mirëkuptimit, të paqes, tolerancës, barazisë gjinore dhe në miqësi me pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në Kosovë.⁹ Prandaj është shumë e rëndësishme që në momentin kur përjashtimi social evidentohet si produkt i sistemit edukativ, institucionet qeveritare t'i ndërrmarrin hapat e nevojshme për adresimin e reformave të nevojshme në kuptim të promovimit të gjithpërfshirjes sociale dhe rritjes së frymës së tolerancës dhe diversitetit etnik. Kjo arrihet më së miri kur kurrikulat dhe tekstet shkollore në shkollat publike në Kosovë të jenë të përshtatshme për të gjithë nxënësit. Tekstet e një anshme shkollore të cilat paraqesin vetëm pikëpamjet e shumicës si norma dhe vlera të përgjithshme shoqërore nuk janë në harmoni me parimet e diversitetit dhe gjithpërfshirjes. Mënyra sesi komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas paraqiten në tekste shkollore ka ndikim në ideologjinë, përceptimin, besimet, njohuritë dhe diskursin e përgjithshëm të nxënësve dhe shoqërisë në ndërveprimin social me ta. Për këtë arsye është e rëndësishme që arrijet dhe vetitë unike kulturore të këtyre komuniteteve të identifikohej, të njihen dhe të paraqiten në tekstet shkollore publike në Kosovë.

Të Gjeturat Kryesore

Të dhënat e analizës hulumtuese tregojnë se fëmijët në tekstet e tyre shkollore nuk gjejnë materiale dhe informacione të mjaftueshme mbi diversitetin dhe veçantitë kulturore të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas në Kosovë. Në përgjithësi, tekset shkollore përmbajnë pak tema ku flitet për diversitetin kulturor të shoqërisë kosovare. Edhe në ato pak tema ku trajtohet ky dimension, përshkrimi i të dhënave dhe informacioneve shpesh është i mangët dhe jo i saktë. Po ashtu, në tekstet shkollore të analizuara, janë identifikuar disa formulime që kanë përmbajtje të gjuhës diskriminuese dhe përjashtuese. Gjuha përjashtuese në bazë të përkatësisë etnike është veçanërisht e theksuar në tekstet shkollore të edukatës qytetare dhe historisë – të cilat janë të mbushura me glorifikime dhe ekzagjerime të pasurisë së një etnie (grupit shumicë) në krahasim me etnitë e tjera. Shembull në tekstin e edukatës qytetare të klasës së tretë, thuhet se “vendi jonë është Republika e Kosovës. Në të banojnë shqiptarë, serbë, turq, boshnjakë, rom, etj”¹⁰. Ky tekst si i tillë ka elemente të gjuhës përjashtuese për faktin se nuk specifikohen dhe nuk përmenden komunitetet e tjera (ashkalinjtë, egjiptasit dhe goranët) të cilat jetojnë në Kosovë dhe për më shumë njihen edhe si kategori kushtetuese. Në po të njëjtin tekst, përmendet fakti se “shqiptarët, serbët, boshnjakët dhe turqit kanë simbolet e tyre etnike dhe kulturore”¹¹. Në këtë fjali, komunitetet e tjera jo shumicë në Kosovë nuk përmenden fare, duke nënkuptuar se grupet e tjera etnike si romët, ashkalinjtë, egjiptasit nuk shquhen për simbolet e tyre etnike dhe kulturore.

⁸ Sanchez, T. R. The social studies teacher's lament: how powerful is the textbook in dealing with knowledge of ethnic diversity and attitude change: Urban Education, 1997 (p.64)

⁹ Neni 1.2.5 – Ligji për Arsimin Parauniversitar në Kosovë

¹⁰ Edukata qytetare për klasën e katërt (2019). Libri shkollor, fq. 60

¹¹ Po aty, fq. 60

Të gjitha grupet etnike në Kosovë i kanë simbolet dhe kulturat e tyre të veçanta me të cilat shquhen, dallohen dhe krenohen. Tekstet e mësipërme nuk janë në përputhje me paraqitjen e karakterit multi-etnik dhe multikulturor të shoqërisë kosovare. Pra edhe në ato pak tema në të cilat trajtohet diversiteti kulturor në Kosovë, përmbajtja e materialit është e mangët dhe jo e saktë.

Analiza e teksteve shkollore po ashtu evidenton se ka një mungesë të plotë të përshkrimit të narracionit historik të komuniteteve të tjera jo-shumicë në Kosovë. Gjithë tekstet shkollore, e në veçanti ato të historisë të arsimit fillor dhe të mesëm të ultë janë kryesisht etno-centrike. Roli i komuniteteve të tjera në rrugëtimin historik të shtetit dhe shoqërisë kosovare është i patrajtuar dhe është lënë jashtë narracionit. Pra, në tekstet shkollore përshkruhet vetëm historia e shqiptarëve (shumicës), ndërsa nuk ka asnjë informacion apo mësim mbi historitë e komuniteteve të tjera pakicë në Kosovë. Përshkrimet e tilla mono-etnike të historisë janë të kundërta me parimet multikulturalizmit, e në fakt mund të perceptohet si tendencë për asimilimin e grupeve të tjera etnike.

Në tekstet shkollore ka dhe formulime të cilat glorifikojnë racën shqiptare në bazë të karakteristikave të tyre specifike. Shembull teksti "Shqiptarët janë tej mase të hijëshem e të matur në sjelljet e veprimet e tyre...ndoshta janë raca më e bukur nga tiparet"^{1 2}. Formulimi i tillë në tekst është manifestim i shpërfaqjes së supremacisë kulturore përmes ilustrimit të klasifikimit të racave sipas karakteristikave dhe tipareve të tyre. Përshkrimet e tilla glorifikuese të një race kanë tendencën e ndërtimit të një sistemi shoqëror me dimension vertikal –

ku e kemi një racë (dominante) në maje dhe gjitha racat e tjera (inferiore) të klasifikuara nën të. Kjo është e kundërta me ndërtimin e dimensionit horizontal të shoqërisë - e cila bazohet në premisen e barazisë në mes grupeve të ndryshme kulturore dhe etnike brenda strukturës shoqërore.

¹² Leximi i klasës së katërt (2019). Libri shkollor, fq. 149.

Konkluzionet

Në përgjithësi, niveli i dhënies së njohurive dhe informacioneve mbi diversitetin kulturor në tekstet shkollore në Kosovë është tejet i limituar. Përmes teksteve mësimore, nxënësit kanë fare pak mundësi të marrin informacione në lidhje me ekzistencën e një shumëllojshmërie të grupeve kulturore dhe etnike brenda shoqërisë kosovare. Historia dhe kultura e këtyre grupeve është tërësisht e injoruar në tekstet shkollore dhe në këtë drejtim nxënësit lehtësisht mund të vijnë në përfundime se mësimi mbi historinë dhe kulturën e tyre është i parëndësishëm. Si rrjedhojë, testet shkollore ekzistuese nuk i përmbushin nevojat mësimore të nxënësve mbi pasqyrimin e drejtë dhe të plotë të karakterit multietnik të shoqërisë kosovare. Në planin afatgjatë, kjo mund të prodhojë një shoqëri e cila karakterizohet me një injorancë të përgjithshme në raport me njohjen e identitetve të tjera etnike në vend.

Në anën tjetër, komunitetet e marginalizuara etnike si romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit ndodhën në pozitë të pafavorshme shoqërore për shkak të diskriminimit dhe paragjytimeve ndaj tyre si forma të manifestimit të antigjipsizmit. Një faktor determinues që ndikon në shfaqjen dhe rritjen e paragjytimeve është mosnjohja e "tjetrit". Prandaj, mungesa e njohurive mbi identitetin, historinë dhe vlerat e tyre kulturore nga komuniteti shumicë mund të jetë pengesë serioze për promovimin dhe zhvillimin e një shoqërie multietnike dhe gjithëpërfshirëse.

Ndërtimi i një sistemi të edukimit bazuar në tekste shkollore gjithëpërfshirëse është një pikënisje e nevojshme dhe e rëndësishme në adresimin e pabarazisë sociale në vendin tonë dhe hap i duhur në luftimin e mënyrave të shfaqjes së antigjipsizmit - si formë specifike e racizmit ndaj Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptasve.

Rekomandimet

- Të bëhet rishikimi/plotësimi i teksteve shkollore përmes qasjes së përfshirjes së dimensioneve kulturore dhe historike të komuniteteve jo-shumicë, me qëllim të eliminimit të gjuhës përjashtuese dhe diskriminuese dhe zëvendësimit të saj me gjuhë gjithëpërfshirëse. .
- Përfshirja e ekspertëve të fushave të antropologjisë dhe njohjes të kulturës të komuniteteve joshumicë në Kosovë, dhe përfshirja e informatave në libra të shkencave shoqërore dhe filologjike.
- Të krijohen njësi të veçanta në tekstet shkollore për historinë dhe kulturën e komuniteteve jo shumicë në Kosovë.
- Të krijohen programe të veçanta të trajnimit për mësuesit mbi ligjërimin e temave të gjithëpërfshirjes sociale dhe diversitetit kulturor dhe nxitjes mbi të menduarit kritik.